



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Mitrovicë, më 24 qershor 2024  
Nr. ref.: RK 2452/24

Prishtinë, më 24 qershor 2024  
Nr. ref.: RK 2452/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI205/23

Parashtrues

**Ramadan Hyseni, Shkumbin Vidishiqi, Mimoza Abazi, Zymer Haliti dhe Gani Selimi**

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC.nr.2051/22] të Gjykatës së Apelit, të 01 qershorit 2023**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka - Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

Kërkesa është parashtruar nga Ramadan Hyseni, Shkumbin Vidishiqi, Mimoza Abazi, Zymer Haliti dhe Gani Selimi, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejshëm: Parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson Sheremet Ademi, avokat nga Mitrovica.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin [AC.nr.2051/22] e Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 1 qershorit 2023, në ndërlidhje me Aktvendimin [CP.nr.1026/2021] e Gjykatës Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), të 27 janarit 2022.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe të nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 25 shtator 2023, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
6. Më 26 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin Nr.GJR.KI205/23 caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI205/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
7. Më 9 tetor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjykata kërkoi që parashtruesit e kërkesës të plotësonin formularin e kërkesës, dhe që përfaqësuesi i tyre të dorëzonte autorizimin specifik për Gjykatë.
8. Më 9 tetor 2023, një kopje e kërkesës së parashtruesve iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 13 tetor 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore të dorëzonte dosjen e plotë (origjinale) të lëndës, brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.
10. Më 23 tetor 2023, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë (origjinale) të lëndës.
11. Më 2 nëntor 2023, parashtruesit e kërkesës dorëzuan në Gjykatë dokumente shtesë, përkatësisht formularin e plotësuar dhe autorizimin specifik për përfaqësim pranë Gjykatës.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

13. Më 27 mars 2024, gjyqtarja Remzije-Istrefi Peci, në përputhje me paragrafin 1 të rregullit 38 (Procedura për përjashtimin e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës së Gjykatës, e njoftoi kryetaren e Gjykatës se është në lidhje familjare me njërin nga parashtruesit e kërkesës dhe kërkoi që të përjashtohet nga procesi i shqyrtimit dhe vendimmarrjes.
14. Më 27 mars 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.ref.:KK196/24]: (i) aprovoi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës Remzije-Istrefi Peci nga procesi i shqyrtimit dhe i vendimmarrjes lidhur me kërkesën KI205/23; dhe (ii) vendosi që gjyqtarja Remzije Istrefi-Peci nuk do të jetë pjesë e asnjë kolegji shqyrtues dhe as pjesë e Gjykatës në përbërje të plotë kur të votohet rasti KI205/23.
15. Më 29 prill 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

16. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesit e kërkesës janë të punësuar në administratën e Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” (në tekstin e mëtejme: UMIB).
17. Më 25 maj 2015, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMSHCK) dhe kërkuan ekzekutimin e rritjes së pagës në vlerë prej 30 përqind në pagën bazë nga UMIB, duke marrë parasysh vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës: [Nr.02/151] të 6 janarit 2011 dhe [Nr.03/177] të 14 marsit 2014.
18. Më 20 korrik 2016, KPMSHCK-ja mori vendim që bazuar në dy vendimet e lartcekura të Qeverisë së Kosovës, sekretari i UMIB-it duhet të nxjerrë një akt administrativ me të cilin ua njeh të drejtën parashtruesve të kërkesës ngritjen e pagës bazë prej 30 përqind, nga data 24 prill 2016 kur parashtruesit kishin bërë ankesë.
19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën në Gjykatën Themelore propozim për përmbarim të vendimit të KPMSHCK-së.  
*(i) Procedura e parë përmbarimore*
20. Më 24 tetor 2016, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [E.nr.236/16] e lejoi përmbarimin e vendimit të KPMSHCK-së.
21. Më 31 tetor 2016, UMIB-u parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore për lejimin e përmbarimit.
22. Më 15 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [AC.nr.331/2017] refuzoi ankesën e UMIB-it dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore për lejimin e përmbarimit.
23. Më 17 prill 2018, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [CPP.nr.236/2016] e urdhëroi UMIB-in t’ia paguaj kompensimin financiar parashtruesve të kërkesës.
24. Në një datë të paspecifikuar, UMIB-i parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore.
25. Më 23 prill 2019, Gjykata e Apelit nëpërmjet Aktvendimit [AC.nr.2245/18] e aprovoi ankesën e UMIB-it dhe ktheu çështjen në rivendosje.

26. Më 21 maj 2019, Gjykata Themelore në rigjykim nëpërmjet Aktvendimit [CP.nr.236/2016]: (i) urdhëroi UMIB-in që të përmbaroj vendimin e KPMSHCK-së, me të cilin obligohet UMIB-i që të nxjerr akt administrativ për rritjen në pagën bazë të parashtruesve të kërkesës; (ii) që parashtruesve të kërkesës t'u paguhet kompensimi financiar në emër të diferencës së pagave nga data 21 prill 2016 deri në dhjetor 2017.
27. UMIB-i parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
28. Më 12 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e UMIB-it si të pathemeltë dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore.
29. Më 22 janar 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [Cp.nr.236/2016] e urdhëroi Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës – Departamenti i Thesarit, që kompensimin financiar në emër të diferencës së pagës ta bartë në llogari të parashtruesve të kërkesës dhe personave të tjerë, në vlerën prej 76.264.65 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, për periudhën kohore 21 prill 2016 deri në dhjetor 2017.
30. Më 1 qershor 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [Cp.nr.236/2016] e përfundoi procedurën përmbartimore, pasi ishte informuar se kishte përfunduar ekzekutimi i kompensimit financiar në llogari të parashtruesve të kërkesës.

*Procedura e dytë përmbartimore*

31. Më 3 shkurt 2020, parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur propozim të ri në Gjykatën Themelore, për përmbartim të vendimit të KPMSHCK-së nga viti 2018 e tutje. Ata pretendonin se UMIB-u nuk e kishte përmbushur obligimin për rritjen e pagave nga viti 2018 e tutje dhe kërkonin kompensimin financiar për diferencën e papaguar.
32. Më 19 shkurt 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [Cp.nr.60/2020] lejoi përmbartimin e propozimit.
33. UMIB-i parashtroi prapësim në Gjykatën Themelore, kundër Aktvendimit [CP.nr.60/2020] të Gjykatës Themelore për lejimin e përmbartimit.
34. Më 26 gusht 2020, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit [Cp.nr.60/2020] refuzoi prapësimin e debitorit si të pabazuar.
35. Më 11 shtator 2020, UMIB-i paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore.
36. Gjykata e Apelit e ktheu çështjen në rivendosje.
37. Më 27 janar 2022, Gjykata Themelore në rigjykim nëpërmjet Aktvendimit [CP.nr.1026/2021] hedhi poshtë propozimin për përmbartim të parashtruesve të kërkesës dhe shfuqizoi vendimin e mëparshëm për lejimin e përmbartimit. Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim:

*“procedura përmbartimore lidhur me lëndën CP.236/2016 i cili vendim ka marrë formën e prerë, ka përfunduar si e tillë dhe pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Unifikimin e të Ardhurave Personale të Punëtorëve të Administratës së Universitetit “Isa Boletini”, në Mitrovicë, kërkesa e kreditorëve është shuar për*

*arsye se nuk ekziston objekti i procedurës përmbarimore, pasi që ndaj kreditorëve është përmbytur obligimi ashtu siç parashihet me vendimin A.nr.A/02/193/2016 i KPMSHCK-së.”*

*“gjkata me Aktvendimin CP.nr.236/2016 të dt. 01.06.2020 e ka përfunduar procedurën përmbarimore, pasi që në të njëjtin është deklaruar se me dt.19.02.2020 gjykata është informuar nga i autorizuari se për lëndën në fjalë është bërë ekzekutimi i shumave sipas aktvendimit të gjykatës. Andaj, bazuar në të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 391 të LPK-së e në të cilin parashihet se “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton si në pikën: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata).”*

38. Më 1 qershor 2023, Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit arsyetoi si në vijim:

*“gjkata e shkallës së parë me aktvendimin CP.nr.236/2016 të datës 01.06.2020 e ka përfunduar procedurën përmbarimore, pas përmbyturjes së detyrimit dhe kjo gjendje faktike nuk ishte kontestuese ndërmjet ndërgjyqësve, andaj gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar kur e ka hedhur si të pa lejueshëm propozimin për përmbarim të kreditorëve...”*

*“Mandej, nuk qëndron pretendimi ankimor i kreditorëve se çështja juridike që është në procedim e sipër nuk është e njëjtë me procedurën e përfunduar me aktvendimin CP.nr.236/2016 të datës 01.06.2020 sepse dallon periudha kohore, ky pretendim është i pa bazuar sepse gjykata e shkallës së parë gjatë vlerësimit ka vepruar konform nenit 49 të LPP-së e cila dispozitë parasheh: Përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarimin apo urdhrin për përmbarim. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kësaj dispozite drejt ka ardhur në përfundim se kjo çështje përmbarimore është e gjykuar më parë sipas dokumentit të njëjtë përmbarimor dhe kjo vërtetohet nga pika II e petitumit të propozimit të KPMSHCK-së të datës 20.07.2016, në këtë dokument përmbarimor e as në petitumin e propozimit për përmbarim nuk parashihet periudhë e as shumë tjetër e përmbyturjes së detyrimit.”*

39. Më 27 qershor 2023, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit.
40. Më 10 gusht 2023, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit nuk e aprovoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës.

### **Pretendimet e parashtruesve të kërkesës**

41. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e të drejtave të tyre, të garantuara me nenet: 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ.

*(i) Në lidhje me interpretimin e gabuar të ligjit*

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktvendimet e gjykatave të rregullta “janë të paqëndrueshme, të pa argumentuara, konfuze, të përgjithësuara e pa arsyetim ligjor”.

43. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Gjykata ka përzier këtë lëndë-propozim për përmbarrim me lëndën përmbarrimore tashmë të ekzekutuar dhe përfunduar me procedurën CP.nr.236/2016. Në procedurën përmbarrimore është ekzekutuar detyrimi i debitorit ndaj kreditorit vetëm për një periudhë kohore dhe atë 21.04.2016 deri 31.12.2017. Detyrimi pas kësaj periudhe nuk është paguar dhe lidhur me këtë çështje, është filluar procedurë e re përmbarrimore për ekzekutimin e detyrimit të mbetur për periudhën sipas ekspertizës financiare.”
44. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Nuk ka asnjë provë të vetme se me Rregulloren për Unifikimin e të ardhurave personale të punëtorëve të administratës së Universiteteve, është shuar e drejta e palëve për realizimin e kërkesave në emër të detyrimit të pa paguar. As provat tjera të pretenduara, nuk kanë realizuar Vendimin e KPMSHCK. Kjo rregullore ka qenë edhe gjatë procedurës së parë përmbarrimore CP.nr.236/16 dhe gjykata qysh atëherë ka vlerësuar se ka ekzekutuar detyrimi dhe nuk është përmbushur edhe pas sjelljes së rregullores. Për të vërtetuar gjendjen faktike, kemi propozuar ekspertizën financiare, e cila ekspertizë ka dhënë mendimin profesional se akoma ekziston detyrimi, se debitori nuk ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorëve, ka konstatuar lartësinë e detyrimit dhe se vendimi nuk është përmbushur në tërësi. Poqe se do të përmbushet detyrimi dhe të konsiderohet si çështje e gjykuar, pse atëherë eksperti financiar ka konstatuar se ka detyrim edhe pas datës 01.01.2018 e tutje.”

(ii) Në lidhje me diskriminimin dhe praktikën divergjente

45. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se: “Në të paktën 4 raste identike, për kreditorët të cilët kanë kërkuar zbatimin e vendimit konkret A/02/193/2016 të dt. 20.06.2016, ka lejuar propozimin për përmbarrim, ka mbajtur seanca gjyqësore, ka dëgjuar palët në procedurë, ka sjell aktvendim me të cilin ka nxjerr ekspertizë financiare për llogaritjen e diferencës, ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka detyruar debitorin që kreditorëve t’ua paguaj shumat sikurse në petitume të dispozitivit. Që të gjithë këta kreditor, kanë realizuar një pjesë të detyrimit sipas vendimit të KPMSHCK, sa i përket periudhës 20.04.2016 deri me datën 31.12.2017. Gjykata ka lejuar në procedurën tani për ligjshmëri, por edhe në të gjitha procedurat përmbarrimore, në ekzekutimin e vendimit të këshillit, nga data 01.01.2018 e tutje. Pra, kemi të bëjmë me periudhë tjetër në të cilën kërkohet përmbarrimi, në bazë të vendimit, i cili nuk ka ndryshuar me asnjë akt, nuk e ka humbur efektin juridik, nuk ka përcaktuar saktësisht një periudhë kohore, por ka përcaktuar një të drejtë-detyrim të kreditorëve ndaj debitorit, i cili detyrim është konstatuar me ekspertizën financiare.”
46. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Konstatimet e gjykatës, përveç se janë të pa drejta, janë mohim i të drejtave të garantuara me Kushtetutë, duke krijuar dallime dhe diskriminim për të njëjtit, me faktin se nëse në disa lëndë të njëjta përmbarrimore është lejuar përmbarrimi, janë refuzuar prapësimet dhe ankesa e debitorit dhe për më tepër është në proces të ekzekutimit lënda, tani gjykata krijon praktikën tjetër, duke refuzuar dhe hudhur poshtë një propozim për përmbarrim, që pas administrimit të provave, është vërtetuar se ekziston detyrimi dhe si i njëjti nuk është përmbushur.”
47. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: “Gjykatat e instancave më të ulëta në mënyrë absolutisht diskriminuese kanë vendosur në aktvendimet e dhëna. Është rrethanë diskriminuese që një institucion, me vendim të tij, të aprovoj ankesën e një pale dhe të refuzoj ankesën e palës tjetër, në kushte dhe gjendje të njëjta juridike.”

**Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore**

## Kushtetuta e Republikës së Kosovës

### Neni 31

#### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
  2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
  3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
  4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
  5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- [...]

### Neni 24

#### [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
- [...]

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

### Neni 6

#### (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
- [...]

## LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

### Neni 27

#### Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor

1. Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit. 2. Në qoftë se me anë të dokumentit përmbarues nuk është caktuar afati për përmbushje vullnetare të detyrimit, afati i tillë do të caktohet me anë të aktvendimit për përmbarimin, dhe urdhrin për përmbarim, për shtatë (7) ditë. 3. Në rastin nga paragrafi 2. i këtij neni, organi përmbarues e cakton përmbarimin e propozuar nëse debitori brenda afatit që i është caktuar për përmbushje vullnetare nuk e përmbushë detyrimin e tij.

**KREU IV**  
**PROPOZIMI DHE CAKTIMI I PËRMBARIMIT**  
**Neni 38**

**Propozimi për përmbarim**

- 1. Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.*
- 2. Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*
- 3. Po qe se bashkë me propozimin për përmbarim është bërë edhe kërkesa për konstatimin e pasurisë së debitorit, për rezultatin e konstatimit të tillë organi përmbarues do ta njoftojë kreditorin duke i lënë afat që ta rregullojë propozimin e paraqitur, respektivisht që ta ndryshoj apo plotësoj atë. Propozimi i ndryshuar dorëzohet brenda dhjetë ditëve pasi që organi përmbarues të ia dërgojë kreditorit deklaratën e pasurive të debitorit. Megjithatë nëse kreditori kërkon aneks të deklaratës, siç përshkruhet në paragrafin 9 nenin 45 të këtij ligji, brenda afatit kohor të lejuar, koha e lejuar për përmbarim të propozimit të ndryshuar për përmbarim llogaritet nga data në të cilën shtojca e dorëzuar nga debitori i dërgohet kreditorit.*

**Neni 43**

**Aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim**

- 1. Në aktvendimin për përmbarimin dhe urdhrin për përmbarim në bazë të titullit përmbarues duhet të tregohet dokumenti përmbarues, kreditori dhe debitori i përmbarimit, kredia që duhet të realizohet, mjeti dhe objekti i përmbarimit, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.*  
[...]

**Neni 49**

**Kufijtë e përmbarimit**

*Përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarimin apo urdhrin për përmbarim.*

**Neni 66**

**Përfundimi i procedurës përmbarimore**

- 1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërin e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar dy (2) herë dhe për herë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.*
- 2. Përmbarimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyrimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit.*
- 3. Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim.*



4. Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore.

### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

48. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113  
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

[...]

50. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”*

51. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuara, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ata kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC.nr.2051/22] e Gjykatës së Apelit të 1 qershorit 2023, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe

nenit 47.2 të Ligjit; kanë specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendojnë se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.

52. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me nënrregullin (2), të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*(2) “Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*  
[...]

53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuzë dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, kategoria (iii).

**Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenin 6 të KEDNJ-së**

54. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimet e gjykatave të rregullta nuk e kanë vërtetuar drejt gjendjen faktike - kur kanë konstatuar se procedura përmbartimore kishte përfunduar në këtë rast.

*(i) Përkitazi me interpretimin e gabuar të ligjit*

55. Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit të bëra nga gjykatat e rregullta. Është në autoritetin e gjykatave të rregullta të zbatojnë dhe interpretojnë të drejtën materiale. Gjykata mund të ndërhyjë vetëm në rastet kur

- vendimet e gjykatave të rregullta janë marrë në mënyrë “arbitrare” apo janë “qartazi të paarsyeshme”, duke shkelur kështu të drejtat kushtetuese të parashtruesve të kërkesës (rastet e Gjykatës, [KI70/11](#), *parashtrues Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 dhjetorit 2011, paragrafi 29-30; [KI06/17](#), *parashtrues L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 tetorit 2017, paragrafi 37; [KI122/16](#), *parashtrues Riza Demboqaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 57; [KI154/17 dhe KI05/18](#), *parashtrues Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafët 60-65; [KI70/20](#), *parashtrues Rasim Shabani dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2021, paragrafët 69-74).
56. Pretendimet për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të dispozitave të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta kanë të bëjnë me çështje të ligjshmërisë, dhe Gjykata nuk mund t’ trajtojë ato për shkak se nuk është pjesë e juridiksionit të saj. (rasti i Gjykatës [KI175/20](#), *parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, para. 42).
57. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në KPMSHCK kundër UMIB-it, për shkak se kjo e fundit nuk i kishte realizuar pagat e tyre në përputhje me vendimet e Qeverisë për rritje të pagës bazë në vlerë prej 30 përqind respektivisht 25 përqind. KPMSHCK-ja me vendim miratoi ankesën e tyre dhe detyroi UMIB-in të nxjerr një akt administrativ nëpërmjet së cilët do të rriste pagat e parashtruesve të kërkesës sipas vendimeve të Qeverisë. Gjykata Themelore lejoji përmbarimin e vendimit të KPMSHCK-së si dokument me titull ekzekutiv dhe sipas ekspertizës financiare detyroi UMIB-in t’ia paguante parashtruesve të kërkesës dhe disa nëpunësve të tjerë, kompensimin financiar në vlerën prej 76.264.65 (shtatëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, për periudhën nga viti 2016 kur u parashtrua ankesa, deri më 2017 kur u zbatua vendimi përmbarimor. Gjykata Themelore e përfundoi procedurën përmbarimore në momentin kur u informua nga thesari i shtetit se detyrimi përmbarimor ishte ekzekutuar sipas vlerës së përcaktuar financiare.
58. Parashtruesit e kërkesës parashtruan përsëri propozim për përmbarim të vendimit të KPMSHCK-së, për periudhën nga viti 2018 e tutje. Sipas tyre, UMIB-i nuk e kishte përmbushur detyrimin për rritje të pagës nga viti 2018 dhe rrjedhimisht vendimi i KPMSHCK-së ende kishte vlefshmëri dhe titull ekzekutiv për përmbarim. Parashtruesit e kërkesës nuk e mohojnë faktin që vendimi i parë për përmbarim i Gjykatës Themelore ishte përmbushur në tërësi, mirëpo pretendojnë se kemi të bëjmë me periudhë tjetër kohore e cila nuk ishte e përfshirë në vendimin e parë për përmbarim. Në anën tjetër, UMIB-i si debitor theksonte se kishte nxjerrë rregullore të brendshme për unifikimin e të ardhurave personale të punëtorëve të administratës dhe se parashtruesit e kërkesës e marrin pagën me rritje sipas vendimeve të qeverisë.
59. Gjykata vëren se, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit refuzuan kërkesën e parashtruesve të kërkesës për lejim e përmbarimit të vendimit të KPMSHCK-së për periudhën pas vitit 2018 e tutje. Gjykata e rregullta arsyetuan se çështja përfundoi në momentin e përmbushjes së detyrimit financiar nga thesari i shtetit në llogari të parashtruesve të kërkesës. Gjykatat e rregullta theksuan se, vendimi i KPMSHCK-së dhe vendimi i Gjykatës Themelore për lejimin e përmbarimit përcaktonin se kush ishte kreditori dhe debitori, periudhën kohore dhe shumën e kompensimit financiar. Duke qenë se ky vendim ishte përmbaruar në tërësi, nuk ekzistonte ndonjë vendim tjetër për përmbarim. Gjykata e rregullta theksuan se me hyrjen në fuqi të rregullores për unifikimin e të ardhurave personale nuk ekzistonte objekti i procedurës përmbarimore.
60. Bazuar në nenin 27 [Përshtatshmëria e dokumentit përmbarimor] të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore, një dokument përmbarimor është i përshtatshëm nëse

aty është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përbushjes së detyrimit. Neni 43 [Aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim] i këtij ligji përcakton që aktvendimi për përmbarim dhe urdhri për përmbarim duhet të tregojë dokumentin përmbarues, kreditorin dhe debitorin e përmbarimit, mjetin dhe objektin e përmbarimit si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Ndërkaq, neni 49 [Kufijtë e përmbarimit] i ligjit përcakton se përmbarimi kryhet brenda kufijve të caktuar në aktvendimin për përmbarim apo urdhrin për përmbarim. Gjykata vëren se, vendimi i Gjykatës Themelore për përmbarim përcaktonte: dokumentin përmbarimor (vendimin e KPMSHCK-së), kreditorin (parashtruesit e kërkesës), debitorin (UMIB), periudhën kohore (2016-2017) dhe lartësinë e kompensimit financiar 76.264.65 (shtatëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) euro. Ky aktvendim ishte përmbaruar në tërësi dhe një gjë e tillë nuk është kontestuese.

61. Gjykata thekson se, nuk ekzistonte ndonjë vendim i ri përmbarimor i Gjykatës Themelore që lidhej më çështjen e parashtruesve të kërkesës, e i cili nuk ishte përmbaruar. Nuk është në juridiksionin e Gjykatës të vlerësojë nëse UMIB-i kishte harmonizuar pagat e parashtruesve të kërkesës sipas vendimeve të Qeverisë edhe pas vitit 2018. Gjykata nuk mund të lëshohet në interpretime të fakteve dhe të ligjit, sepse një gjë e tillë e kanë bërë gjykatat e rregullta. Nga ato që u theksuan më lart, duket që procedura e zhvilluar në tërësi ishte e drejtë dhe nuk mund të thuhet që gjykatat e rregullta vendosën në mënyrë arbitrare apo qartazi të paarsyeshme.

62. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkitazi me interpretimin e gabuar të ligjit, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj shpallen si qartazi të pabazuara.

*(ii) Përkitazi me divergjencën e praktikës gjyqësore*

63. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit vendosën ndryshe në disa raste të tjera, përkundër faktit që ato raste ishin identike me rastin e tyre. Sipas parashtruesve të kërkesës, jokonsistenca e gjykatave të rregullta përbën diskriminim dhe dëmtoi të drejtat e tyre.

64. Parashtruesit e kërkesës i referohen pesë aktvendimeve të Gjykatës Themelore: [CP.nr.26/2023] i 31 majit 2023; [Cp.nr.135/20] i 15 prillit 2021; [Cp.nr.59/2020] i 18 shkurtit 2021; [Cp.nr.61/20] i 9 marsit 2020; [Cp.nr.58/20] i 15 prillit 2021.

65. Parashtruesit e kërkesës i referohen edhe 2 aktvendimeve të Gjykatës së Apelit: [AC.nr.4038/21] i 17 nëntorit 2021, që refuzoi ankesën për shkak se ishte paraqitur jashtë afatit dhe vërtetoi aktvendimin [Cp.nr.61/20] e Gjykatës Themelore, të 9 marsit 2020; dhe [Ac.nr.5640/21] i 5 prillit 2023, që vërtetoi aktvendimin [Cp.nr.135/20] e Gjykatës Themelore, të 15 prillit 2021.

66. Gjykata përsërit se divergjencat e vendimeve gjyqësore janë pjesë e çdo sistemi gjyqësor që është i ndërtuar mbi disa shkallë të gjykimit. Këto divergjenca mund të lindin edhe brenda të njëjtës gjykatë. Në vetvete, këto divergjenca të vendimeve gjyqësore nuk përbëjnë shkelje të KEDNJ-së (rasti i GJEDNJ-së, [Pinto kundër Portugalisë](#), nr. 39005/04, Aktgjykim i 20 majit 2008, para. 41). Është roli i Gjykatës Supreme të zgjidhë konfliktet e divergjencës së praktikës gjyqësore (rasti i GJEDNJ-së, [Beian kundër Rumanisë](#), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, para. 37). Nuk mund të konsiderohet që ka divergjencë atëherë kur situata faktike e rasteve është e ndryshme. (rasti i GJEDNJ-së, [Erol Ucar kundër Turqisë](#), nr. 12960/05, Vendim i 29 shtatorit 2009).

67. Gjykata përsërit se bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, nuk është funksioni i saj për të krahasuar vendimet e ndryshme të gjykatave të rregullta. Parashtruesit e kërkesës kur ngritin çështjen e divergjencës së vendimeve të gjykatave të rregullta, duhet të paraqesin argumente në lidhje me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve për të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta. Rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtruesit të kërkesës duhet të jenë identike me rastet të cilat i referohet parashtruesi i kërkesës. (rasti i Gjykatës [KI175/20](#), parashtrues Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri i 26 marsit 2021, para. 61-63; [KI42/17](#), parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, para. 33-41; [KI29/17](#), parashtrues Adem Zhegrova, Aktvendim për papranueshmëri i 5 shtatorit 2017, para. 47-51; [KI142/15](#), parashtrues [Habib Makiqi](#), Aktvendim për papranueshmëri i 14 shtatorit 2016, para. 39).
68. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, Gjykata përsërit se vlerësimi i divergjencës së praktikës gjyqësore bëhet mbi tre kritere kryesore: (i) nëse kundërthëniet e pretenduara të praktikës gjyqësore janë të “thella dhe afatgjata”; (ii) nëse ekzistojnë mekanizma për të zgjidhur divergjencën përkatëse; (iii) nëse këto mekanizma janë zbatuar në mënyrë efikase. (rasti i Gjykatës [KI116/21](#), parashtrues [Sali Rexhepi](#), Aktgjykim i 19 korrikut 2022, para. 42; [KI78/21](#), parashtrues [Raiffeisen Bank Kosovo](#) cituar më lart, para. 94; [KI87/18](#), parashtrues “[IF Skadeforsikring](#)”, cituar më lart, para. 67; rasti i GJEDNJ-së, [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, para. 116). Kur praktika e vendimeve divergjente zhvillohet brenda autoritetit më të lartë gjyqësor atëherë një gjë e tillë përbën shkelje të parimit të sigurisë juridike, që është një nga parimet kryesore të sundimit të ligjit. (rasti i GJEDNJ-së, [Beian kundër Rumanisë](#), cituar më lart, para. 39).
69. Gjykata kishte gjetur shkelje kushtetuese për shkak të divergjencës së praktikës gjyqësore, në rastet kur Gjykata Supreme kishte vendosur ndryshe në raste tërësisht të njëjta, në dëm të parashtruesve të kërkesës. Gjykata kishte theksuar se është detyrë e Gjykatës Supreme, si autoriteti më i lartë gjyqësor, të kujdeset për praktikën e saj gjyqësore, për të shmangur pasigurinë juridike dhe për të rritur besimin e publikut në administrimin e drejtësisë. (rastet e Gjykatës [KI89/13](#), parashtrues [Arbresha Januzi](#), Aktgjykim i 12 marsit 2014, para. 52- 62; [KI133/20](#), parashtrues [Raiffeisen Bank Kosovo](#), J.S.C., Aktgjykim i 30 marsit 2022, para. 168-170; [KI78/21](#), parashtrues [Raiffeisen Bank Kosovo](#) J.S.C. Aktgjykim i 30 marsit 2022, para. 140; [KI87/18](#), parashtrues “[IF Skadeforsikring](#)”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, para. 82-88; [KI35/18](#), parashtrues “[Bayerische Versicherungsverband](#)”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, para. 109-111).
70. Në lidhje me aktvendimet e Gjykatës Themelore të cilave i referohen parashtruesit e kërkesës, Gjykata vëren se rrethanat faktike të rasteve të lartpërmendura janë të ngjashme me rrethanat e rastit të parashtruesve të kërkesës. Në rastet e cituara më lart, Gjykata Themelore kishte vendosur që vendimi i KPMSHCK-së - që kishte njohur të drejtën e punëtorëve të UMIB-it për rritje të pagës, duhet të përmbarohej edhe nga viti 2018 e tutje, për shkak se eksperti financiar kishte vlerësuar se rregullorja për unifikimin e pagesave të punëtorëve të UMIB-it nuk e kishte inkorporuar rritjen e pagave sipas vendimeve të qeverisë dhe se ekzistonte ende detyrimi financiar i UMIB-it ndaj punëtorëve të vet. Ndërkaq, në rastin e parashtruesve të kërkesës, Gjykata Themelore hedhi poshtë propozimin për përmbarim të vendimit të KPMSHCK-së nga viti 2018 e tutje, me arsyetimin se vendimi i KPMSHCK-së ishte ekzekutuar dhe rregullorja për unifikimin e pagave të punëtorëve e kishte adresuar çështjen e ngritjes së pagave për parashtruesit e kërkesës.

71. Duket që Gjykata Themelori mori vendime të ndryshme për raste të ngjashme. Megjithatë, Gjykata Themelore është gjykatë e shkallës së parë dhe në procedurën përmbartimore instanca më e lartë është Gjykata e Apelit. Me fjalë të tjera, vendimet e Gjykatës Themelore të cilave i referohen parashtruesit e kërkesës nuk janë të formës së prerë. Gjykata nuk e di nëse ato vendime e kanë kaluar filtrin e Gjykatës së Apelit dhe janë bërë përfundimtare.
72. Në lidhje me vendimet e Gjykatës së Apelit të cilave i referohen parashtruesit e kërkesës, Gjykata vëren se në një rast Gjykata e Apelit e kishte vërtetuar vendimin e Gjykatës Themelore - që lejonte përmbartimin e vendimit të KMPHCK-së edhe nga viti 2018 e tutje, përderisa në rastin e parashtruesve të kërkesës vendosi ndryshe. Mirëpo, Gjykata ripërsërit se nuk mund të konstatohet jokonsistencë në praktikën gjyqësore me krahasimin e vetëm 2 (dy) rasteve, edhe nëse të njëjtat mund të jenë kundërthënëse (rasti i Gjykatës, [KI102/22](#), parashtrues Faton Aliu, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2023, para. 59).
73. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës përkritazi me jokonsistencën e praktikës gjyqësore, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, prandaj refuzohen si qartazi të pabazuara.

#### **Përkritazi me pretendimet e tjera**

74. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës, pretendojnë edhe në shkelje të neneve 21, 53 dhe 56 të Kushtetutës. Megjithatë Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe e neneve të instrumenteve a konventave që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të atyre neneve, në qoftë se më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe KEDNj-së si dhe të instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
75. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e neneve të lartcekura, në baza kushtetuese duhet deklaruar qartazi të pabazuara.
76. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve të kërkesës, në pajtueshmëri me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 29 prill 2024, njëzëri

## VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Bajram Ljatifi



Gresa Caka-Nimani